



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 55, datë 28.03.2022

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË VEPRIMTARISË SË KËSHILLIT TË LARTË
TË PROKURORISË PËR VITIN 2021**

Bazuar në nenin 149/a, germa dh, të Kushtetutës, nenin 164, pika 8 dhe nenin 181, Ligjit nr. 115/2016, “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, Vendimit nr. 134/2018, “Për miratimin e manualit të monitorimit vjetor dhe periodik”, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, dhe Vendimit nr. 1, datë 11.01.2022, të Konferencës së Kryetarëve, “Për miratimin me mirëkuptim të Program të Punës dhe kalendarit vjetor të Kuvendit për raportimin e institucioneve të pavarura për veprimtarinë e vitit 2021 dhe ushtrimin e kontrollit parlamentar të Komisioneve për vitin 2022”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë

V E N D O S I:

1. Miratimin e raportit të veprimtarisë së Këshillit të Lartë të Prokurorisë për vitin 2021.
2. Raporti t’i dërgohet Kuvendit të Republikës së Shqipërisë brenda datës 31.03.2022.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.
4. U shpall në Tiranë, sot më datë 28.03.2022.

